

BASHKIM ARIZAJ



Kryeauditues ne Departamentin e Auditimit të Performances. Lindur në 1962, në Tiranë. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1986).
Eksperiencë pune: 25 vjet, Eksperiencë pune në KLSH: 18 vjet. Kryeauditues, pas shtatorit 2013.
Fusha e ekspertizës: Financat publike

JA PËRSE NUK DUHET TË RRRITET MOSHA E PENSIONIT...¹

nga Bashkim Arizaj

Këto ditë po diskutohet ndërmarrja e një reforme në pensionet, e cila po hartohet nga specialist të Ministrisë së Financës dhe asaj të Punës. Në thelb të kësaj reforme qëndron rritja e moshës së pensionit të pleqërisë me 5 vite, për gratë mendohet të bëhet 65 vjeç dhe për burrat 70 vjeç. Nisur nga kjo tendence e rritjes së moshës së pensionit, Konfederata e Sindikatave është shprehur kundër rritjes, duke dhënë argumentimin e saj se, “skema aktuale e pensioneve është deficietare dhe mbahet nga buxheti i shtetit. Por për të balancuar atë nuk është e nevojshme të rritet mosha e daljes në pension. Një mënyrë e rregullimit të kësaj skemë është ndërhyrja me ligj, dhe ndër të tjera duhet të zhvishet nga barrët e tepërta, pensionet e parakohshme, suplementare, të ushtarakëve, të dëshmorëve, etj, etj”.

Marr shkas nga këto diskutime dhe dua të kujtoj se, në muajin korrik të këtij viti Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar një auditim në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë. Në raportin e auditimit, krahas të tjerave, KLSH i rekomandon Këshillit të Ministrave, MF, MPÇSSHB dhe ISSH-së

të ndërmarrin një reformë të plotë ligjore, për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore. Po t'i bëjmë një analizë të hollësishme këtij rekomandimi do të vërejmë se KLSH është nxitur pikërisht nga performanca e dobët dhe përkeqësimi i treguesve të vitit 2012, kryesisht në lidhje me mbledhjen e kontributeve dhe me shpenzimet për pensione. Dhe, pikërisht nga ky përkeqësim i treguesve, vetëm gjatë vitit 2012 është krijuar një defiçiti mjaft i madh i pensioneve rreth 21 miliardë lekë.

Pra, skema aktuale e pensioneve dukshëm është defiçitare dhe financohet nga buxheti i shtetit, por për të balancuar këtë buxhet, nuk është e nevojshme që të rritet mosha e daljes në pension, por duhet të luftohet informaliteti dhe evazioni fiskal në mbledhjen e kontributeve të sektorit privat, si dhe abuzimet me shpenzimet e tepërta për pensionet.

Mjafton të përmendim çka ka konstatuar KLSH për të kuptuar se ndërmarrja e një reforme që ka në thelb vetëm rritjen e moshës së pensionit duhet të jetë e fundit për nga rëndësia dhe për vetë problemet sociale që mund të mbartin, konkretisht:

Në mbledhjen e ardhurave nga kontributet:

1. Mosrealizimi i të ardhurave të programuara si pasojë e shmangies së pagesës së kontributeve nga të punësuarit në subjektet private, rezulton në shumën 2,166 milionë lekë. Po kështu, mosrealizimi i të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi ka rezultuar në shumën 386 milionë lekë, shkaktuar kryesisht si pasojë e largimit të një pjese të popullsisë nga zonat rurale në drejtim të zonave urbane, dhe tërheqjen nga skema e 46,222 persona ose në masën mbi 25% të atyre që kanë plotësuar vjetërsinë e nevojshme prej 35 vitesh punë dhe nuk paraqesin interes për sigurim.

Gjithashtu, të ardhurat nga sigurimi vullnetar rezultojnë me një mosrealizim në shumën 23.3 milionë lekë, shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejt nga mosrealizimi i numrit të personave të siguruar.

2. Mospërfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore në fshat të një numri mjaft të madh personash. Konkretisht, numri fizik i personave që nuk kanë paguar kontribute si persona të vetëpunësuar në bujqësi për vitin 2012 rezulton rreth 111,709 persona dhe nga mospagesa e kontributeve prej tyre evazioni në fushën e sigurimeve llogaritet në shumën 2,319 milionë leke.

3. Gjendja e lartë e detyrimeve të kontributeve të papaguara nga subjektet private në fund të vitit 2012 rezultoi në shumën 8,054 milionë leke, duke zënë rreth 8.9% të totalit të të ardhurave të planifikuara për këtë vit. Madje, vetëm gjatë vitit 2012, janë shtuar detyrimet e kontributeve me 320 milionë lekë.

4. Problem shqetësues prej disa vitesh vazhdon të jetë mosdorëzimi i listëpagesave nga subjektet e biznesit të vogël e të madh, sidomos të listëpagesave tremujore të biznesit të vogël. Në fund të vitit 2012, rezultoi se mungojnë gjithsej 268,930 listepagesa, çka ka sjellë vështirësi në përcaktimin e masës së pensionit të pleqërisë dhe në evidentimin e borxhit të subjekteve për kontributet e papaguara ose të paguara pjesërisht.

Në fushën e shpenzimeve për përfitime:

1. Shpenzimet për "Pensione" në total në krahasim me realizimin e vitit 2011, rezultojnë me rritje në vlerën 4,240 milionë lekë. Rritja më e madhe e këtyre shpenzimeve është evidentuar në pensionet e qytetit, pasi shumë përfitues që punojnë si të vetëpunësuar në bujqësi, për arsye të mbushjes mbi 50% të viteve të vjetërsisë në punë në marrëdhënie sigurimi, përfitojnë pensione qyteti.

2. Nga rritja e inflacionit në vitin 2012, shpenzimet për pensione u shtuan me 4,476.4 milionë leke ose në masën 5.4%, me shumë kundrejt realizimit të vitit 2011. Vlen të pasqyrohet se rritja e pensioneve nuk ka ardhur në raport të drejtë me rritjen e inflacionit të këtij viti, pasi pensionet janë rritur në masën 5.4%, ndërsa inflacioni sipas INSTAT varion nga 3-4%.

3. Për vitin 2012, numri i personave të mbuluar me kontribute të buxhetit të shtetit për kategori të veçanta personash rezultoi 33,394 persona dhe rreth 50% e këtij numri e përbejnë ushtaraket dhe ish punonjës të nën tokës. Këto kategori trajtohen me përfitim duke filluar nga moshë 42 vjeç deri në moshën 60-65 vjeç. Bashkimi i të gjitha përfitimeve që financohen nga buxheti i shtetit për këto kategori sjellin një efekt financiar të trefishtë apo katërfishtë për Buxhetin e Shtetit, çka ndikon në deficitin e degës së pensioneve dhe krijon disbalancime të theksuara në masën e përfitimit të pensionit midis kategorive të tjera.

4. Për t'i cilësuar se vendimmarrjet e KMCAP, rajonale dhe eprore, kanë sjellë raste të shumta të informalitetit në dhënien e pensioneve të invaliditetit, me pasojë shtimin e padrejtë të shpenzimeve të kësaj kategorie, duke thelluar kështu deficitin e degës së pensioneve.

5. Rritja nga viti në vit e vlerës së shpenzimeve për komisione të pagesave të përfituara nga Posta Shqiptare sh.a. për shërbimin e pagesave të pensioneve, konkretisht me rreth 200 milionë lekë krahasuar me vitin 2006, ndërkohë që numri i personave dhe pensionistëve që u kryhet shërbimi nga viti 2006 deri në vitin 2012 është rritur me rreth vetëm 10%.

Janë pikërisht këto arsye që KLSH ka rekomanduar të ndërmarret një reformë e plotë ligjore, për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore, në lidhje me:

a) Nivelin e personave të siguruar, pasi aktualisht rezulton një pjesëmarrje në kontribute rreth 65% të forcave aktive të punës.

- b) Formulën aktuale të pensionit, e cila nuk ofron nxitje të mjaftueshme për pjesëmarrje, me arsyen e thjeshtë se pensioni maksimal është i limituar sa dy herë e pensionit minimal edhe pse paga më e lartë është pesë herë më e madhe nga e ulëta.
- c) Evazionin fiskal, pasi është shumë i lartë si pasojë e informalitetit dhe deklarimit të të ardhurave më të vogla se sa janë në realitet, çka ka sjellë pakësimin e bazës kontributive dhe nuk nxit apo motivon punonjësit me të ardhura mesatare apo të larta për të deklaruar e paguar kontribute sipas të ardhurave faktike që marrin.
- d) Mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensioneve, pasi shkalla e zëvendësimit të pagës me pensionin në momentin kur punonjësit dalin në pension pleqërie është e ulët për punonjësit me paga mesatare dhe paga të larta.
- e) Skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare, pasi konstatohen mbulime me subvencione buxhetore edhe për këto skema, shpenzimet për përfitimet e tyre vazhdojnë të rriten nga viti në vit.
- f) Sistemin e pensioneve, pasi dega e pensioneve paraqitet me defiçit të madh, duke kaluar mbi 1% të PBB-së, edhe pse 55% e kontributeve rurale financohen nga buxheti i shtetit.

ⁱ Botuar në Gazetën "Ekonomia" dt. 29 Dhjetor 2013